

@PAGA

Moduli i pagave @Paga eshte nje program me eficence te larte, i bazuar ne rregulla e tregues per llogaritjen e pages dhe qe merr parasysh kerkesat ne ndryshim te nje organizate me qellim reduktimin e kostove, te ngarkeses administrative dhe te gabimeve te llogaritjeve.

@Paga ndihmon ne perlllogaritjen dhe kontabilizimin automatik te listpageses. Perlllogaritja e pagave ne program mund te behet ne çfardo tip monedhe te konfiguruar paraprakisht. Nderfaqet dhe formularet e programit te pagave jane dy-gjuhesh: shqip dhe anglisht; per me teper, programi mund te perdoret me vete, ose si pjese e nje pakete kompjuterike kontabiliteti.

Zgjidhje e bazuar ne tregues dhe ne formule

Cdo organizate ka kerkesa specifike te menaxhimit te pages, ndaj eshte e nevojshme te perdoret nje pakete standarde perlllogaritje page si dhe lehtesisht e konfigurueshme qe te marr parasysh nevojat e vecanta te organizates. Programi @Paga te mundeson te percaktosh kerkesat e perlllogaritjes se listepageses, te cilat reflektojne politikat e biznesit te kompanise.

Programi @Paga bazohet ne tregues te ndryshem te pages, te cilet

konfigurohen lehtesisht ne sistem, sipas politikës së llogaritjes së pages

së organizates. Keto tregues mund të ndryshohen në program, duke marr parasysh faktin që kerkesat janë dinamike.

@Paga mundeson kontroll të plotë mbi formulën dhe rregullat e llogaritjes së pages. Në këtë mënyrë modelohen rregullat e biznesit. Programi i pagave @Paga, pas konfigurimit dhe pas futjes së të dhënave baze, kërkon vetëm futjen e të dhënave për pjesëmarrjen në punë për çdo punonjës, duke plotësuar treguesit përkatës të pages. Të gjitha perlllogaritjet dhe kontabilizimet do të kryhen në mënyrë të menjëherëshme dhe automatike nga programi. Saktësia është siguruar me vlera të parapercaktuara të sistemit dhe nëpërmjet kushtëzimeve në procesin e punës.

Sistemi perlllogarit automatikisht cdo element te pages dhe gjeneron ndalesat (tatime, sigurime mjeksore dhe shoqerore detajuar sipas Punedhënesit dhe Punemarresit) sipas legjislacionit tatimor në fuqi. Në program, nëse lind nevoja ligjore e ndryshimit të formulave të llogaritjes së ndalesave kryesore të sigurimeve dhe tatimit, ato mund të ndryshohen

shpejt dhe lehte. Përdoruesi ka mundësi të përpunojë të dhënat e përlogaritura nëse e mendon të

arsyeshme. Pas gjenerimit të listepageses, @Paga realizon në mënyrë automatike kontabilizimin e pagave, duke ndjekur rregullat e kontabilizimit të konfiguruar para praktikisht.

Disa vecori kyçe

Programi @Paga vjen si një zgjidhje dinamike dhe efiçente për gjenerimin automatik të listepageses. Disa nga vecorit kryesore të tij listohen më poshtë:

- Lehtësisht i konfigurueshem dhe efiçent
- Me saktësi të lartë dhe i sigurt
- Llogaritje e bazuar në tregues të konfigurueshem në sistem
- Formule llogaritje page lehtësisht e ndryshueshme
- Llogaritje automatike e ndalesave si sigurimet shoqërore, shëndetësore, tatimi
- Në gjuhën shqipe dhe i konfigurueshem për çdo monedhë
- Kontabilizim automatik i listepageses së gjeneruar